



CENTER FOR ECONOMIC ANALYSES (CEA)
Shkup, Maqedoni

Korniza e Politikave Publike

**Përftimet dhe shpenzimet nga investimet e huaja të drejtpërdrejta në zonat
zhvillimore teknologjike industriale**

Rasti: Maqedonia për periudhën kohore 2007-2014

Qendra për Analiza Ekonomike – QAE

Shkup
Janar, 2016

1. Vizioni

Avancimi i politikave për të tërhequr investime të huaja të drejtpërdrejta (IHD) në zonat zhvillimore teknologjike industriale (ZZHTI) për qëndrueshmëri më të madhe të investimeve në afat të gjatë, përfitime më të mëdha ekonomike dhe konkurrencë të rritur dhe kompatibilitet me politikat e avancimit të investimeve vendore.

Objektivat dhe rezultatet:

- Rritje e konsiderueshme të vlerës së shtuar nga IHD në ZZHTI për përshejtimin e zhvillimit ekonomik, për zhvillimin e teknologjive të reja dhe për aplikimin e tyre në ekonominë nacionale, rritjen e konkurrencës dhe rritjen e punësimit.
- Avancimi i politikave për të tërhequr IHD të cilat fokusohen mbi reformat në drejtim të rritjes së vlerës së shtuar vendase përmes reformave strukturore për përforsimin e arsimit dhe aftësive, si dhe për sigurimin e infrastrukturës më të mirë.
- Harmonizim dhe kompatibilitet me zonat industriale dhe me zonat e gjelbra, në mënyrë që të sigurohen lidhjet afariste dhe integrimi i subjekteve të ZZHTI me ekonominë vendase.
- Transparencë dhe llogaridhënie për efektet e ndihmës shtetërore për tërheqjen dhe qëndrueshmërinë e IHD, në përputhje me legjislacionin evropian dhe rekomandimet e autoriteteve monitoruese nacionale.


2. Analiza:

1. Mungesa e transparencës dhe mungesa e të dhënave dhe informatave për lartësinë e shpenzimeve për subvencionimin e IHD dhe mosharmonizimi me legjislacionin evropian sa i përket transparencës së ndihmës shtetërore;
2. Njoftimi jo në kohë i investitorëve, mungesa e kriterëve për zgjedhje dhe lidhje të kontratës me IHD, planifikim jo i plotë i mjeteve të Buxhetit të RM-së, si dhe mungesë e monitorimit dhe evaluimit të efekteve të arritura;
3. Vlera e shtuar bruto e kompanive në ZZHTI është me efekt të prolonguar kohor, ndërkaq deri më tani efekt pozitiv kanë tri nga shtatë kompani;
4. Ndihma shtetërore që u është akorduar shfrytëzuesve në ZZHTI ka ndikim të konsiderueshëm financiar mbi vendimin që të investojnë në Maqedoni, ndërkaq qëndrueshmëria e investimeve, në afat më të gjatë edhe pas përfundimit të periudhës së lehtësimeve tatimore, është kontestuese. Largimi pas skadimit të periudhës së përfitimit të subvencioneve pas vitit të dhjetë mund të rezultojë me rrjedhjen e kapitalit, përjashtimin nga puna të punëtorëve dhe nevojën e kërkimit të investitorëve të tjerë në ZZHTI.
5. Kompanitë përfituese në ZZHTI, për financimin e mjeteve me një pjesë konsiderueshëm më të madhe financohen përmes obligimeve me palë të ndërlidhura (kompani mëma), ndërsa në masë më të vogël përmes rritjes së kapitalit, me ç'rast kompanitë në ZZHTI paguajnë shpenzime për norma interesi, që pasqyrohen në fitimin e reduktuar, shpërndarjen e reduktuar të fitimit dhe në tatimin mbi fitim, potencialisht më të ulët për shpërndarjen e fitimit;

6. Neto pagat e paguara mesatare për të punësuarit e kompanive, mesatarisht janë në nivel të mesatares nacionale, por ky nuk është rast edhe me numrin më të madh të kompanive, kështu që promovimi i vazhdueshëm i fuqisë së lirë të punës dhe njëkohësisht edhe i politikës për tërheqjen e teknologjive të avancuara nuk pasqyrohet në çmimin e fuqisë së punës, e që e konteston efektin e transferimit të njohurive dhe rrjedhjen e njohurive në kompanitë e tjera të sektorit;
7. Përfitimi potencial i eksternaleve pozitive siç është rrjedhja e njohurive është i pritshëm por përballet me sfida duke e pasur parasysh faktin se sektorët të cilët janë gjeneratorë të njohurive të reja, si dhe tranferimi ose rrjedhja e njohurive: hulumtim dhe zhvillim, marketing, shitje, janë ruajtur tek kompanitë mëmë ose tek qendrat rajonale, e që e kufizon faktorin rrjedhje të njohurive si argument për tërheqjen e IHD në RM.

Së këtëjmi, nevojitet që politikat për tërheqjen e IHD të fokusohen mbi një strategji të qëndrueshme, matjen e performansave me indikatorë të cilët i pasqyrojnë objektivat e politikave.

Harta e palëve kryesore të interesit



Progresi i politikave fillimisht do të matet përmes identifikimit, matjes dhe publikimit të indikatorëve në lidhje me performansat si rezultat të ndihmës së akorduar për IHD.

3. Analiza PESTLE

Ndikimi politik – stabiliteti politik nacional dhe rajonal ka ndikim kyç mbi tërheqjen por edhe mbi qëndrueshmërinë e investimeve, veçanërisht kur politikat e shteteve të rajonit mundësojnë masa “të ngjashme” dhe politika të orientuara në drejtim të tërheqjes së IHD; ndryshime në politikën fiskale, si dhe politikat tatimore do të kenë efekt mbi tërheqjen, si dhe mbi ruajtjen e investimeve në shtet;

Ndikimi ekonomik – rritja dhe zhvillimi global ekonomik kanë ndikim mbi avancimin e efekteve të IHD meqë tregjet kryesore të produkteve të shfrytëzuesve të ZZHTI janë tregjet e huaja, si dhe për furnizimin e inputeve; shkalla e lartë e papunësisë në shtet përkundrejt nevojës së fuqisë së kualifikuar të punës për procese prodhuese specifike, shfrytëzuesit mund t’i përballë me shpenzime të rritura sa i përket fuqisë së punës;

Ndikimi social – IHD kanë ndikim mbi rritjen e punësimit, impakti më i lartë i të cilit pritet në periudhën e ardhshme;

Ndikimi teknologjik – sektorët dhe veprimtaritë “e reja” përmes IHD mundësojnë transferim potencial të teknologjive të reja përmes investimeve të reja tek investitorët e tjerë, por edhe tek biznes/furnizuesit lokal;

Ndikimi juridik – harmonizimi i legjislacionit sa i përket transparencës së ndihmës shtetërore me legjislacionin evropian;

Ndikimi mbi mjedisin jetësor – ZZHTI janë jashtë vendbanimeve dhe kjo ka ndikim pozitiv mbi qytetarët; tërheqja e investitorëve është/duhet të fokusohet mbi proceset që nuk ndotin dhe proceset e avancuara teknologjike të cilët nuk janë ose janë ndotës të lehtë; ndryshimet plotësuese të legjislacionit, të cilat kanë të bëjnë dhe ndërliken me mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe avancimin e standardeve, do të kenë ndikim mbi shfrytëzuesit e ZZHTI.

4. Të shikosh përpara

Skenarë dhe Rreziqe

Skenar i dëshirueshëm:

Indikatorë të përkufizuar për seleksionimin dhe evaluimin e matjes së performansave të IHD nga aspekti ekonomik dhe financiar

Pasqyrë transparente për ndihmën e akorduar të IHD, në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe implementimin e rekomandimeve të organeve mbikëqyrëse


Analiza Eks Ante dhe Eks Post të performansave të IHD në lidhje me ndihmën e akorduar

Politika dhe masa të avancuara sa i përket integritet të funksionimit të zonave të gjelbra industriale, në përputhje me ZZHTI në lidhje me funksionimin më efikas të politikave për mbështetjen e investimeve vendase dhe të huaja

Ndryshime strukturore në mënyrën e tërheqjes së IHD në mënyrë që të vendoset qëndrueshmëria e investimeve.

Për realizimin e skenarit të dëshirueshëm ekzistojnë Rreziqet, si vijojnë:

Rreziqe:



Rreziku politik – shkalla: e lartë. Ndryshimi i politikës së shtetit për mbështetjen dhe qëndrueshmërinë e IHD në ZZHTI si dhe stabiliteti politik është njëri nga faktorët kyç për tërheqjen dhe qëndrueshmërinë e investimeve të huaja në shtet; faktorët politikë rajonal kanë ndikim mbi efektet e politikave vendase.

Rreziku financiar – shkalla: e mesme. Rrezik nga mbështetja financiare e paqëndrueshme e IHD përmes ndihmës shtetërore, subvencionimit dhe efekteve mbi konsumin publik.

Rreziku i komunikimit - shkalla: e ulët. Rrezik nga mosrealizimi i komunikimit efektiv midis bartësve të politikave, zbatuesve të politikave dhe administratës, si dhe ndërmjet shfrytëzuesve të ZZHTI.

Rreziku administrativ – shkalla: e mesme. Rreziku nga kapaciteti administrativ për monitorimin dhe evaluimin e efekteve nga mbështetja e shfrytëzuesve të ZZHTI.

5. Ndikimi

Opsion për arritjen e epilogut/rezultatit të dëshirueshëm i përshkruar si skenar i dëshirueshëm, efikasiteti, konsistenca, shpenzimet dhe realizimi i tij ndërlidhen edhe me rreziqe në një mjedis me ndikime të jashtme.

Sa i përket realizimit të ndikimit mbi vendimmarrësit kryesorë nevojitet përdorimi i mekanizmave për përfaqësim dhe për lobim, duke filluar nga: prezantimi i konstatimeve dhe rekomandimeve, pasqyrimi i resurseve të nevojshme për ndryshime, komunikimi i drejtpërdrejtë me vendimmarrësit dhe me kreatorët e politikave. Përfshirja e vendimmarrësve dhe kreatorëve të politikave është element kyç në procesin e vlerësimit të politikave, sa i përket mbështetjes dhe tërheqjes së IHD. Shfrytëzuesit e ZZHTI në mënyrë plotësuese përmes përfshirjes në aktivitete të cilat do të mundësojnë transparencë dhe komunikim më të madh me publikun dhe me bizneset lokal, me qëllim që të mundësohet transferim më i madh i njohurive në formë të modeleve të suksesshme. Faktorët e tjerë, të cilët janë “përgjegjës” për menaxhimin me shpërndarjen e ndihmës shtetërore, si dhe për monitorimin e rezultateve, duhet të vendosin indikatorë qartësisht të përcaktuar për seleksionimin dhe evaluimin e matjes së performansave të IHD, si nga aspekti ekonomik ashtu edhe nga ai financiar dhe të njëjtat t’i diskutojnë në mënyrë transparente.

6. Bërja e ndryshimit: Si të sigurohemi se funksionojnë politikat e propozuara publike?

Mënyrat, me të cilat mund të ndikojmë mbi faktorët prej të cilëve varen politikat, janë përmes shkëmbimit të informatave lidhur me politikat dhe strategjinë e investimeve të huaja, matjes së performansave dhe nivelit të arritjes së qëllimeve të dëshiruara, përmes përgatitjes së politikave të sublimuara, takimeve me kreatorët e politikave dhe përmes vendosjes së komunikimit të dyanshëm. Hapja e debateve për çështjen e efekteve nga IHD është njëri nga hapat e parë që nevojiten për monitorimin e politikave.

7. Vlerësimi dhe nxënia: Si duket suksesi? Si mund t'i shfrytëzojmë leksionet të cilat i kemi mësuar?

Nevojiten strategji afatgjata pozitive të cilat mundësojnë investime të qëndrueshme, e që janë harmonizuar me politikat për mbështetjen e investimeve vendase, me përfitime më të mëdha ekonomike, si dhe kompatibilitet me politikat për avancimin e investimeve vendase, me ç'rast avancimi i politikave do të matet përmes indikatorëve të qartë dhe të matshëm sa u përket performansave, si rezultat i ndihmës së akorduar për IHD. Së këtejmi, implementimi i rekomandimeve të hulumtimit, thellimi i tij, implementimi i rekomandimeve të ESHR, harmonizimi me mbështetjen e investitorëve vendas, duhet të monitorohet në mënyrë që të përcaktohet suksesi i politikës në fjalë për mbështetjen e investimeve të huaja, me ndryshime të orientuara në drejtim të ruajtjes së investitorëve edhe pas periudhës dhjetëvjeçare të përfitimit të subvencioneve të konsiderueshme. Konstatimet e analizës i vunë në dukje nevojat për:

- Transparencë të avancuar për ndihmën e akorduar të IHD
- Implementimin e rekomandimeve të organeve mbikëqyrëse
- Analizë Eks Ante dhe Ekst Post të performansave të IHD
- Integrimin e funksionimit të zonave të gjelbra industriale
- Ndryshime strukturore të mënyrës së tërheqjes së IHD me fokus mbi ofertën e shërbimeve për shfrytëzuesit.